



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ
KRYETARI

Nr. 1811 Prot

Maliq, më 25.03.2021

VENDIM

Nr. 16, datë 25.03.2021

Për

“Afishimin e Materialeve Popagandistike”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma (a), Ligj Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, Neni 78 “Afishimi i materialeve propagandistike”, Udhëzimi nr.6, datë 23.03.2021 “Për përdorimin e materialeve propagandistike e edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore”,

VENDOS :

1. Afishimi i materialeve propagandistike në Bashkinë Maliq dhe Njësitë Administrative do të bëhet në stenadat e informimit për publikun.
2. Afishimi i materialeve të tjera zgjedhorë si flamuj dhe postera do të lejohet vetëm në një largësi deri në 5 metra nga zyra zgjedhore e partisë politike apo subjektit zgjedhor.
3. Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: “*Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore....*”(vijon emir i subjektit zgjedhor).
4. Çdo material propagandistik i vendosur në kundërshtim me këtë vendim do të hiqen menjëherë nga Policia Bashkiake.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Policia Bashkiake.
6. Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

